

BISEDË ME U.D DREJTORESHËN E FSPIM, BILJANA JOVANOVSKA

# BASHKËPUNIMI NË NIVELIN E DËSHIRUAR

"Kujdesi i Fondit pensional nuk ndalet me marrjen e një vendimi për pension, por vazhdon në procedurën gjatë ushtrimit të drejtave, pagesën e pensioneve, pagesën e ndihmës pas vdekjes, specifikimin e të dhënave për mbledhjen e kuotizacioneve të anëtarësisë dhe përmirësimin e përgjithshëm të sistemit pensional", tha drejtoresha e FSPIM, Biljana Jovanovska



Bashkëpunimi ndërmjet Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor dhe Shoqatës së Pensionistëve të Maqedonisë është në nivelin e dëshiruar, në interes të pensionistëve aktualë dhe atyre të ardhshëm. Deri më tani, Shoqata ka pasur lidhje të mira me Fondin, gjë që është e natyrshme dhe e domosdoshme për shkak të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara në aktet dhe Programet e punës të Fondit dhe Shoqatës. Bashkëpunojnë për gjithçka që lidhet me pensionistët aktualë dhe të ardhshëm brenda kufijve të mundësive në mënyrë që jeta e pensionistëve të jetë më cilësore dhe më e mirë.

"Ishte ashtu dhe do të jetë kështu edhe në të ardhmen. Unë personalisht do të angazhohem në maksimum në atë drejtim me gjithë njohuritë, përvojën dhe kapacitetin tim intelektual, së bashku me ekipin tim. Kujdesi i Fondit pensional nuk ndalet me marrjen e një vendimi për pension, por vazhdon në procedurën gjatë ushtrimit të drejtave, pagesën e pensioneve, pagesën e ndihmës pas vdekjes, specifikimin e të dhënave për mbledhjen e

kuotizacioneve të anëtarësisë dhe përmirësimin e përgjithshëm të sistemit pensional", tha drejtoresha e FSPIM, Biljana Jovanovska.

Në kuadër të bashkëpunimit, drejtoresha Jovanovska ishte mysafire e LSHPM-së dhe iu përgjigj pyetjeve që ishin drejtpërdrejt të bëra nga pensionistët në linjën "Alo - Pyetjet e pensionistëve". "Së pari, dua të them se ideja për t'iu përgjigjur drejtpërdrejt pyetjeve që pensionistët do të bëjnë në linjën telefonike 'Alo-Pyetjet e pensionistëve' ishte e imja, e përcaktuar në një nga takimet tona të punës me presidenten e Shoqatës, Stanka Trajkova, ndërsa pyetjeve do t'iu përgjigjem edhe herëve të tjera që do t'iu imponojë koha aktuale. Sa i përket 'vizitës' dhe përgjigjes së pyetjeve, ishte kënaqësia dhe nderi im që t'iu përgjigja pyetjeve të qytetarëve tanë më të vjetër", informoi Jovanovska.

Për çfarë më pyesnin, vazhdoi me tej ajo në formë pyetje. "Për shumë gjëra. Këtu janë disa nga pyetjet së bashku me përgjigjet e mia: Pse zgjat kaq shumë procedura për marrjen e pensionit? (Procedura nuk është e

thjeshtë, por unë jam duke punuar në mënyrë intensive që afati i parashtrimit të kërkesës deri në sjelljen e vendimit për pension të jetë më i shkurtër. Ju lutem paraqituni në këtë numër ose në Fondin dhe do të bëhet shqyrtim dhe do të merren masa); A do të ketë edhe këtë vit rekreacion për bajë (po nëse kushtet shëndetësore lejojnë për shkak të pandemisë së Covid 19); A do të ketë pako të pestë dhe a do t'iu përfshijë pensionistët dhe cilët? (kjo do të vendoset nga Qeveria, ndërsa ne si fond do të bëjmë gjithçka që është e mundur që masat të arrijnë sa më shpejt të jetë e mundur dhe në mënyrë të sigurt)...", tregoi drejtoresha e FSPIM, ndërsa shtoi se kishte më shumë pyetje nga kujdesi shëndetësor si p.sh. nëse lista pozitive e barnave do të zgjerohet, a do të ketë teste falas për Covid-19, kur pensionistët do të vaksinohen, etj., të cilave iu përgjigja brenda kufijve të tim të njohurisë.

"Jam në dispozicion që edhe në të ardhmen të kam këtë lloj komunikimi të drejtpërdrejt me pensionistët aktual dhe atyre të ardhshëm". (K.S.A)

BOTOHET LIBRI I TODOR ILIEVIT

## Një punim autobiografik me plot emocione dhe ngrohtësi

Dëshmia për njeriun dhe jeta e tij nuk janë fjalë të bukura, por veprat e mëdha dhe të mira. Vërtetimi i këtij rregulli të artë që buron nga përvoja e njerëzimit është edhe libri i pensionistit Todor Iliev me titull "Zapisi od mojt zivot" i cili u botua në fund të vitit të kaluar, ndërsa u mbështet financiarisht nga LSHPM. Vepra proze e Ilievit është një punim autobiografik në të cilën gjurmohen mënyrat kronologjike të jetës dhe telat krijues nga Negorci i tij i lindjes, Gjevgjeli, deri në ditët e sotme. Narracioni në vetën e parë është një parim që konfirmon të vërtetën e kohërave, ngjarjeve dhe njerëzve nga njëra anë, për të cilat autori shkruan me sinjeritet, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe krijon një tekst që lexohet me interes dhe lehtësi nga ana tjetër. Le të vëmë re se vitet e fundit shfaqja e veprave të tilla letrare me një karakter memoar është kënaqësi sepse teksti i shkruar mbetet një dokument i përhershëm i asaj që ka qenë dhe që ka kaluar. Vepra ka një rëndësi të veçantë sepse përmban edhe elemente monografike për shoqatën e pensionistëve nga komuna e Çairit.

Proza në librin e Ilievit është e mbushur me shumë ndjenja, emocione dhe ngrohtësi që sigurisht e përcaktojnë edhe karakterin e autorit të saj. Pastaj, ai i kushton vëmendje të veçantë secilit karakter, ndodhi ose ngjarje dhe si piktori me furçë, kështu që Iliev me fjalë i paraqet gjërat në detaje. Ky parim jo rrallë u ngjall lexuesve ndjenjën sikur ai ish-



te i pranishëm ose një dëshmitar në atë që lexon dhe së bashku ata krijuan histori me titull të vendosur me kuptimin e tyre thelbësor si shkrime të jetës. Todor Iliev shkruan për fëmijërinë e tij, shpirtin e shqetësuar dhe kurioz fëmijor, por edhe për dashurinë e tij më të madhe - të mësuarit. Ajo është rruga ose më saktë ideali që do të ndjekë tërë jetën. I aftë dhe i plotësuar, gjithmonë me vullnet të mirë dhe energji pozitive përmes mësimin të vazhdueshëm, me mund dhe punë, të gjitha dyert hapen para tij. Ai shkruan jo vetëm për veten e tij, por edhe për mjedisin në të cilin secili person formohet si person dhe krijues i vlerave të

reja krijuese.

Faqe veçanërisht të bukura për t'u lexuar janë ato ku ai tregon për traditat popullore maqedonase, zakonet, marrjen e nënës së tij me mblesëri, dashurinë dhe besimin e popullit me festat fetare Ortodokse si Kolede, Vasilica, Shën Teodor, Shën Gjergji dhe të tjerët. Bëhet fjalë për një autor që ka ushqyer dashuri dhe lidhje të veçantë për shtëpinë dhe familjen. Në kronikën e tij të jetës, vend dhe kuptim të veçantë kanë momentet me shoqëruesen e jetës, dy vajzat si njerëz të mirë dhe të suksesshëm, nipërit dhe mbesat që janë nderi dhe dinjteti i tij. Mundi dhe puna janë e vetmja masë e njeriut. Pas pensionimit, Todor Iliev e vazhdon ose përmirëson jetën e tij me vlera të reja. Kyçet në jetën dhe aktivitetet e SHP Çair. Sukseset e tij si kryetar i Komisionit për sport dhe rekreacion dhe si anëtar i Bordit Ekzekutiv të SHP Çair janë tejet të njohshme. Ai dhe gruaja e tij gjithashtu janë aktivë në grupin e të kënduarit, ndërsa ai është i njohur si pjesëmarrës në garat rajonale dhe kombëtare të pensionistëve të organizuara nga LSHPM. Ai shkruan në librin e tij edhe për aktivitetet e tij në SHP Çair, ndërsa ajo pjesë e librit duket si një monografi për shoqatën. Libri i Todor Iliev "Zapisi od mojt zivot" ka një stil dhe gjuhë të pranueshme si për lexuesit e rinj ashtu edhe për ata të moshuar, ndërsa këto shkrime do të mbeten të regjistruara në historinë e SHP Çair dhe LSHPM. (prof.dr. V. Tocinovski)

SHOQATA E PENSIONISTËVE NË ÇAIR

## Takim me kryetarin e Komunës së Çairit



Kryetarja e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova, së bashku me delegacionin e SHP-Çair, më 10 mars 2021 realizuan takim me kryetarin e Komunës së Çairit, Visar Ganiu, i cili u njoftua me aktivitetet aktuale të Lidhjes dhe me problemet e përditshme me të cilat ballafaqohen pensionistët e SHP Çair. Fillimisht, kryetarja Trajkova si shenjë falënderimi për mbështetjen të cilën kryetari Ganiu, në kuadër të mundësive të tij, gjithmonë është i gatshëm ta ofrojë ndaj kërkesave të pensionistëve, i dha një kopje nga Monografia e LSHPM-së me dedikim nga kryetarja Trajkova, ku është zhvendosur teksti i revysë muzikore në të cilën ishte prezent kryetari, ndërsa nikoqir ishte SHP Çair dhe një kopje nga gazeta "Penzioner plus".

Një përfaqësues i SHP Çair e njoftoi kryetarin për rrugën e zhvillimit dhe punën e shoqatës, me çka theksoi se kjo është edhe një nga takimet e shumta në të cilën flitet për mbështetjen e kësaj kategorie të qytetarëve, me qëllim që të përmirësohen kushtet e tyre për jetesë. Veçanërisht u fol për sigurimin e hapësirave për degët e Shoqatës, të cilat do t'iu shërbejnë si klube për shoqërim të përditshëm të pensionistëve nga pjesët e ndryshme të komunës. Në fund e cekti bashkëpunimin e mirë tradicional të qeverive komunale, i u falënderua kryetari Ganiu për atë që komuna dhe ai personalisht kanë bërë për pensionistët dhe e shfaq mbështetjen e tij për aktivitetet e ardhshme të përbashkëta.

Në atë takim, kryetari Ganiu e cekti bashkëpunimin e mirë me pensionistët, duke theksuar që të gjitha aktivitetet dhe nevojat e tyre janë të mbështetura nga Komuna, duke theksuar që kujdesi i moshës më të moshuar të qytetarëve vazhdon të përparojë, me qëllim të mundësimin për ditë më të mira dhe më të lumtura pensioniste.

Kryetari premti që kujdesi ndaj klubeve pensioniste në Komunën Çair do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe paralajmëroi se do të angazhohet që për periudhë të shkurtë të gjinden objekte përkatëse, për të cilat qiraja dhe inventari do të jenë në barrë të Komunës. Në fund, u shfaq falënderim ndaj Komunës dhe kryetarit Ganiu për mbështetjen e vazhdueshme dhe u vlerësua që takimi ishte produktiv. (Vasil Paçemski)